



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:019997

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05860773

PPP.nr.23/2023

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përmbartimore e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit F. Sh. , nga fshati ... Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqësona Avokati Q. B. nga Kaçaniku, rruga Bulevardi "...", kundër debitorit, Komuna H. E.- D. për b. dhe f., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore më datën 26.06.2024 mori dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. REFUZHET Prapësimi i debitorit, K. H. E.-D. për B. dhe F., i ushtruar më datën 31.01.2023, kundër Aktvendimit mbi lejimin ekzekutimit E.nr.25/2023, i datës 24.01.2023 në tërësi **SI I PABAZUAR**

II. DETYROHET debitori që ta bëj pagesën e shumës prej 1,200.00€. Këtë shumë me kamat prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga data 23.01.2023, data e dorëzimit të propozimit, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 186,00€. Këto pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori F. Sh. , nga fshati ... K. H. E. , përmes të autorizuarit Avokat Q. B. nga Kaçaniku, me datën 23.01.2023, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka ushtruar propozim për përmbarrim, kundër debitorit Komuna Hanit Elezit-Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Kreditori me propozimin për përmbarrim, ka kërkuar që të lejohet ekzekutimi dhe të detyrohet debitori Komuna Hanit Elezit, që kreditorit të ja paguaj shumën prej 1,200.00€, në emër të shujtës ditore për vitet 2020, 2021 dhe 2022. Kreditori , shumën e kërkuar me propozim për përmbarrim, e ka kërkuar me kamat prej 8 %. Po ashtu ka kërkuar që ti paguhen edhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në shumë prej 186,00€.

Kreditori propozimin për përmbarrim, e ka bazuar në titullin ekzekutiv edhe atë në vendimet e Kuvendit Komunal: vendimit 01Nr.9153/2020, i datës 29.12.2020 dhe vendimin 02.Nr.839/2021, i datës 03.02.2021, të cilat vendime i plotësojnë kushte e parapara me nenin 22 pika 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-139, Ligjit për procedurën përmbarrimore. Po ashtu kreditori propozimit për përmbarrim ja ka bashkangjitur konfirmimin për mjetet buxhetore Nr.04/856/2021 dhe Listat e punonjësve të administratës komunale.

Gjykata me datën 24.01.2023, e ka nxjerr aktvendimin mbi lejimin e ekzekutimit E.nr. 25/2023, po me të njëjtin aktvendim e ka njoftuar debitorin, që në afat prej 7 ditëve, mundë të paraqesin prapësim, kundër aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit.

Gjykata me datën 25.01.2023, propozimin me prova ja ka dorëzuar debitorit, i cili në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim.

Debitori me prapësim, i ka propozuar gjykatës, që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet aktvendimi E.nr.25/2023, i datës 24.01.2024, pasi që konsiderojnë se gjykata me rastin e lejimit të ekzekutimit, nuk i ka vlerësuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, sepse provat e paraqitura nga ana e Kreditorit, nuk kanë titull ekzekutiv. Ka theksuar se propozimi për përmbarrim, nuk është bazuar në dispozitat e neneve 27 dhe 36 të LPP-së,

Gjykata e analizoi propozimin për përmbarim, provat e bashkangjitura, prapësimin e debitorit dhe pas analizimit të tyre, prapësimin e debitorit e refuzoi si të pa bazuar, sepse pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura si më lart jo vetëm që nuk kishin mbështetje provuese, por të njëjtat ishin të pa justifikueshme në aspektin ligjor.

Propozimi Përmbarimor, të cilin e ka lejuar gjykata, është i ligjshëm i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të LPP-së. Gjykata ka gjetur se provat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim, janë prova të cilat bazohen në dispozitat e LPP-së, sipas neneve 21, 22 par 1.2 , 24 par 3 dhe nenit 27 par 1 të LPP-së.

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit, si të pa bazuar, sepse debitori prapësimin nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë ashtu siç është paraparë me neni 69 par 4 të LPP-së. Me këtë dispozitë është paraparë, baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi duhet të refuzohet.

Duke marrë për bazë gjendjen faktike, gjykata rrjedhimisht konstaton se debitori nuk ka paraqitur, asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 e deri tek pika 1.12 të LPP-së, prandaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Meqenëse e debitori ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e të autorizuarit të kreditorit e detyroi debitorin që kreditorit në shumat e kërkuara t'ia paguaj edhe kamatën në lartësi prej 8 % , duke filluar nga data 23.01.2023, data e dorëzimit të propozimit , e deri në pagesës definitive konform nenit 382 të LMD-së.

Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorit, të paraqitura me propozim për përmbarim, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarim dhe të detyrohet debitori që kreditorit të ja paguaj shumat e kërkuara. Këtyre pretendimeve gjykata u a dha besimi, sepse propozimi për përmbarim, i përmban të gjitha elementet e parapara me nenin 38 të LPP-së, është i bazuar në dokumentin përmbarimor, ashtu siç është paraparë me nenet sipas neneve 21, 22 par 1.2 , 24 par 3 dhe nenit 27 par 1 të LPP-së.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e debitorit, të paraqitura me prapësim në raport me përshtatëshmerin e dokumentit përmbarimor ku u kundërshtuan Vendimi 01 Nr. 9153/2020, i

datës 29.12.2020 dhe vendimi 02.Nr.839/2021, i datës 03.02.2021, si dokument të cilat nuk janë të pambarueshme sipas Ligjit të procedurës përbarimore.

Gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara, sepse e vërtetoi se propozimi për përbarim, është ngritur në bazë të vendimit 01 Nr.9153/2020, i datës 29.12.2020 dhe vendimin 02.Nr.839/2021, i datës 03.02.2021, të Komunës së Hanit të Elezit, të cilat janë në përputhje me nenin 22 par.1.2 të LPP-së.

Me këtë dispozitë thuhet se: “Dokument përbarues është edhe vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi” e kjo njëherit është në përputhje me nenin 23 par. 2, lidhur me nenin 24 par.3 i LPP-së, ku thuhet se:“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po që se është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.

Prandaj gjykata në rastin konkret konsideron se përbarimi është në përputhje të plotë me ligjin, njëherit konsideron se debitori ka dështuar në përmbushjen vullnetare të detyrimit që ka pasur konform vendimeve 01 Nr.9153/2020, i datës 29.12.2020 dhe 02.Nr.839/2021, i datës 03.02.202, respektivisht pika 6 e vendimit 29.12.2020, prandaj vlerëson se janë përmbushur kriteret e përshtatshmërisë së dokumentit përbarimorë.

Duk e marrë për bazë gjendjen faktike, gjykata rrjedhimisht konstaton se debitori nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika1.1 e deri tek pika1.12 të LPP-së, prandaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i ka analizuar pretendimet e debitorit, të paraqitura me prapësim, me të cilin ka kërkuar që propozimi të refuzohet, sepse nuk i përmban elementet nga nenet 27 dhe 37 të LPP-së.

Këto pretendime, gjykata nuk i mori për bazë, me rastin e vendosjes, sepse propozimi për përbarim, i përmban të gjitha elementet e parapara, me nenin 27 të LPP-së. Po ashtu nuk qëndrojnë edhe pretendimet se vendimet e bashkangjitura , nuk janë në origjinal apo në kopje të vërtetuara. Kreditori me parashtrësën e datës 05.03.2024, gjykatës ja ka dorëzuar kopjet e vendimeve të vërtetuara.

Gjykata po ashtu e ka analizuar edhe pretendimin se vendimet nuk janë të pambarueshme, këto pretendime gjykata i refuzoi si të pa bazuar, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me vendime administrative, të nxjerra na Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës.

Sa i përket përmbarushmërisë, në rastin konkret kemi vendime administrative, të cilat bëhen të pambarueshme 15 ditë, pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr. 03/1-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe neneve 8 dhe 9 të Rregullores (QRK), nr. 20/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës dhe pas shpalljes publike dhe në tabelën e shpalljeve në faqen zyrtare të Komunës.

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit të i'a paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 186,00€, edhe atë shumën prej 156.00€, në emër të propozimit për përmbarim dhe shumën prej 30,00€, në emër të taksës për propozim. Gjykata për shpenzime e procedurës ka vendosur, konform nenit 13. par.4 të LPP-së, dhe udhëzimit administrativ 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore. .

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.25/23 prej datës 26.06.2024

Gjyqtari:

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 26.06.2024

Kreditorit 1x1

Debitorit 1x1